

KËRKESË
Nr. 2685, datë 14.5.2019

PËR RIPUBLIKIMIN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR SHËRBIMIN E
KONSULENCËS LOKALE “ASISTENCË TEKNIKE PËR TË KRYER NJË VLERËSIM
TË GJENDJES SË INVALIDËVE TË PUNËS”
Ref. no. SAMP/CS/CQ/09-2019

Tiranë 13.5.2019

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)
Hua No.: 8841- AL
Nr. i identifikimit të Projektit. P162079

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim shtesë nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (“Shërbim”) së kërkuar është “Asistencë teknike për të kryer një vlerësim të gjendjes së invalidëve të punës”.

Shërbimet e konsulencës ("Shërbimet") përfshijnë hartimin (duke sjellë përvojat ndërkombëtare) e kritereve të rishikuara të vlerësimit të përshtatshmërisë për përfitimet e aftësisë së kufizuar për kategorinë e invalidëve të punës, e marrëveshjeve të rishikuara institucionale së bashku me rishikimet e nevojshme ligjore siç janë rregulloret/udhëzimet e reja për administrimin e programit të asistencës për aftësinë e kufizuar. Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë nga dy ekspertë socialë me përvojë të zgjeruar profesionale në lidhje me zhvillimin e sektorit social dhe/ose reformat e programit të mbrojtjes sociale. Konsulenti pritët të fillojë shërbimin në qershor 2019 dhe vazhdon deri në gusht 2019.

Termat e detajuara të Referencës (TOR) për këtë shërbim gjenden në faqen e internetit si vijon:
<http://www.shendetesia.gov.al/kerkesa-per-shprehje-interesi/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit SAMP fton të gjithë konsulentët legjitimë (“Konsulentë”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion ku të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.

Kriteret e shortlistimit janë:

1. Biznesi kryesor dhe vitet në biznes	20 pikë
2. Eksperienca specifike e firmës në fushën e shërbimit	40 pikë
3. Organizimi teknik dhe menaxherial i firmës	10 pikë
4. Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tre viteve të fundit	30 pikë
Total	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në Seksionin III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17 të "Rregullave të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI", të datës korrik 2016 ("Rregullat e Prokurimit").

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse shoqata është në formën e një “joint venture” apo në formën e nën-kontraktimit. Në rastin e një “joint venture”, të gjithë partnerët në “joint venture” do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për të tërë kontratën, në rast se përzgjidhet.

Një konsulent do të zgjidhet në përputhje me metodën e “Përzgjedhje Bazuar në Kualifikimet e Konsulentit – CQ”, në përputhje me procedurën e përcaktuar në “Regullat e Prokurimit”.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00-16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00-14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi, ose me e-mail) deri në **29 maj 2019**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (samp)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Kati I

Rr: “Kavajës”, Nr. 53, AL - 1001, Tiranë, ALBANIA

Në vëmendje të: Znj. Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com